

SHËNIMET SHPJEGUESE

Sgarim:

- Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 15
- Plotesimi i të dhënave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 15.
- Rradha e dhënies së shpjegimeve duhet të jetë:
- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
 - b) Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
 - c) Shënime të tjera shpjeguese

A I

Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabël i aplikuar : Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.(SKK 15)
- 3 Baza e përgatitjes së PF : Mbi bazën e konceptit të materialitetit.(SSK 15)
- 4 Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare: (SKK 15)

1. NJESIA EKONOMIKE S&M Construction shpk ka mbajtur në llogarite e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta.

2. VIJIMESIA e veprimtarisë ekonomike të njesisë sone raportuese është e siguar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj.

3. KOMPENSIMI: midis një aktivi dhe një pasivi nuk ka, ndërsa midis të ardhurave dhe shpenzimeve ka vetëm në rastet që lejohen nga SKK.

4. KUPTUESHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plote për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

5. MATERIALITETI është vlerësuar nga ana jone dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zera materiale.

6. BESUESHMERIA për hartimin e Pasqyrave Financiare është e siguar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mëposhtme:

- Parimin e paraqitjes me besnikëri
- Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
- Parimin e paanëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm
- Parimin e maturisë pa optimizim të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm
- Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vertetë e të drejtë të PF.
- Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikën e metodat kontabel
- Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II

Politikat kontabël

Për përcaktimin e kostonë së inventareve është përdorur metoda e mesatares së ponderuar.

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kostonë.

Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, kostonë e huamarrjes (dhe interesat) është metoda e kapitalizimit në kostonë e aktivitetit për periudhën e investimit.

Për vlerësimin e mëposhtëm të AAM është zgjedhur modeli i kostonë duke i paraqitur në bilanc me kostonë minus amortizimin e akumuluar.

Për llogaritjen e amortizimit të AAM njesia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të A.A.M metodën e amortizimit mbi bazën e vlefes së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëllojta me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht:

- Për ndërtesat me 5 % të vlefes së mbetur.
- Komputera e sisteme informacioni me 25 % të vlefes së mbetur
- Të gjitha AAM të tjera me 20 % të vlefes së mbetur

Për llogaritjen e amortizimit të AAJM njesia ekonomike raportuese ka përcaktuar si metode të amortizimit të lineare me normën e amortizimit 15 % në vit.

C

Shënime të tjera shpjeguese

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat behen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabel të mëparshme të konstatuara gjatë periudhës raportuese dhe që korigjim nuk ka.

Ky subjekt për vitin 2025 nuk ka ushtruar aktivitet



ADMINISTRATORI
ZEF MARKU